# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-421808**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Spitali i Vushtrrisë pezullon nga puna dy kirurgët ndaj të cilëve u ngrit aktakuzë për marrje ryshfeti |
| ADRESA | `https://kallxo.com/lajm/spitali-i-vushtrrise-pezullon-nga-puna-dy-kirurget-ndaj-te-cileve-u-ngrit-aktakuze-per-marrje-ryshfeti/` |
| BURIMI | kallxo.com |
| GJENDJA | unreachable |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 7 shtator 2026, 03:13:26 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 2 shtator 2026, 20:04:52 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `44083e6cce4b0cd696a481b19e36c4b5488947c21a731940780803a21e9dce21` |
| TEKSTI | `fe88b1f65cfea6c425a920cf1b28704c56d36f2118b59ff252d6838dded6a46f` |
| PAMJA | `d90a827fa54f0d5d550b94deb08395362952bf29f104b621f6c1060ad9cb4ef5` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `a494efb98837acef437d7569eb84543b887b3f94fc476d7e4e1d5bd3332fc22c` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `c73b9db3b820e04b50f750a03f22fa10ff4921dd00c9878ab3e6c4922c61ec25` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/a494efb98837acef437d7569eb84543b887b3f94fc476d7e4e1d5bd3332fc22c`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

notification icon

Kliko PO dhe abonohu për lajmet dhe hulumtimet kryesore të ditës

JO PO




**Spitali i Përgjithshëm i Vushtrrisë "Sheikh Zayed"**

# Spitali i Vushtrrisë pezullon nga puna dy kirurgët ndaj të cilëve u ngrit aktakuzë për marrje ryshfeti

[Arbrita Uka]

**[Arbrita Uka]**

02.9.2026 - 22:04

[Bëhu pjesë e kanalit tonë në Viber]

Dy kirurgët e Spitalit të Përgjithshëm në Vushtrri, Ekrem Sefiu dhe Valdet Rexhepi, janë pezulluar nga puna pasi gjatë ditës u raportua se është ngritur aktakuzë ndaj tyre si të dyshuar për marrje ryshfeti.

Vendimin e ka bërë të ditur Spitali i Përgjithshëm në Vushtrri, sipas së cilit, të dy mjekët janë të pezulluar deri në përfundimin e procesit gjyqësor.

“Ky institucion shpreh përkrahje të plotë për punën e organeve të drejtësisë dhe konfirmon angazhimin e vazhdueshëm për forcimin e kontrollit të brendshëm dhe transparencës në ofrimin e shërbimeve shëndetësore.” – thuhet në njoftimin e Spitalit, më 02.09.2026.



KALLXO.com raportoi gjatë ditës për ngritjen e aktakuzës ndaj Ekrem Sefiut dhe Valdet Rexhepit nga Prokuroria Themelore në Mitrovicë.

Aktakuzë është ngritur edhe ndaj të pandehurve F.V., B.Q., F.Xh., B.G., B.A., K.H., S.N., V.Y., L.K., të cilët dyshohet se u kanë dhënë ryshfet doktorëve.

Sipas Prokurorisë, mjeku Valdet Rexhepi në gjashtë raste dhe Ekrem Sefiu në tre raste, në mënyrë të drejtpërdrejtë kanë kërkuar dhe pranuar para në shuma të ndryshme për të ofruar shërbime të trajtimit mjekësor për pacientët.

Në anën tjetër, siç bën të dituar Prokuroria, nëntë të pandehurit akuzohen se në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, për vete apo për persona të tjerë, u kanë ofruar mjekëve shuma të ndryshme parash, nga 50 deri në 300 euro, si shpërblim për operimin e familjarëve të tyre.

“Prokuroria Themelore në Mitrovicë, me rastin e ngritjes së aktakuzës ka kërkuar nga gjykata që të pandehurit ti shpallë fajtorë për veprat e kryera penale dhe t`i dënojë sipas ligjit”- thuhet në njoftim.

[Aktakuzë ndaj dy kirurgëve në Vushtrri për marrje ryshfeti]

Më 16.07.2026, KALLXO.com raportoi se dy kirurgët [do të mbrohen në liri].

Kjo pasi Prokuroria e Mitrovicës nuk kishte bërë kërkesë për vazhdimin e masës së arrestit shtëpiak apo të ndonjë mase tjetër, duke vlerësuar se kanë pushuar kushtet për një kërkesë të tillë.

Kirurgët nga Vushtrria nuk figurojnë për herë të parë në regjistrat e Prokurorisë.

Në vitin 2017, Valdet Rexhepi ishte dënuar për marrje ryshfeti me gjobë prej 400 eurosh dhe me gjashtë muaj burgim.

Sipas Gjykatës, më pas dënimi me burgim ishte zëvendësuar me gjobë në shumën prej 2 mijë euro.

Ndërkaq, Ekrem Sefiu kishte qenë nën masën e arrestit shtëpiak nga 10 janari 2023 deri më 9 shkurt 2023.

Po ashtu, sipas zëdhënësit të Prokurorisë, Departamenti për Krime të Rënda kishte ngritur aktakuzë më 30 korrik 2024 ndaj Sefiut për veprën penale – marrja e ryshfetit.

Arrestimi i dy kirurgëve ishte bërë më 13 maj 2026.

aktakuza kundër kirurgëve Ekrem Sefiu Marrje ryshfeti Spitali i Përgjithshëm Vushtrri Valdet Rexhepi Vushtrri


- Facebook Share

Shpërndaje

- Twitter Share

Cicëroje




**Të Fundit**

### Punime në rrjet, KEDS tregon se ku do të ketë ndërprerje të rrymës të hënën

KEDS
06.9.2026

### Gjendet pa shenja jete një 62- vjeçar në Mitrovicë

avni zahiti

### Ferizaj, 7-vjeçari goditet nga vetura, drejtuesi i automjetit largohet nga vendi i ngjarjes

aksident me të lënduar

### Dy të arrestuarit për sulm ndaj kapitenit të Njësive Speciale, Besart Ahmetit, janë djem të një polici të Kosovës

Arrestimi

**Kryesore**

### Si ia ngatërroi klinika private rezultatet e ekzaminimit një pacienti nga Podujeva dhe e shpalli me kancer?

aloka
06.9.2026

### Hulumtim: Përpjekja për korruptimin e prokurorit në Malishevë

Korrupsioni

### Çfarë moti do të mbretërojë në Kosovë në javën e dytë të shtatorit?

Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës

### 27-vjetori i themelimit të Policisë së Kosovës, Kurti: Kosova është e sigurt si asnjëherë më parë

Albin Kurti

### Dy të arrestuarit për sulm ndaj kapitenit të Njësive Speciale, Besart Ahmetit, janë djem të një polici të Kosovës

Arrestimi

**Të ngjashme**

### Si ia ngatërroi klinika private rezultatet e ekzaminimit një pacienti nga Podujeva dhe e shpalli me kancer?

aloka

### 27-vjetori i themelimit të Policisë së Kosovës, Kurti: Kosova është e sigurt si asnjëherë më parë

Albin Kurti

### Hulumtim: Përpjekja për korruptimin e prokurorit në Malishevë

Korrupsioni

### Presidenti ukrainas pret emisarët amerikanë që u takuan me Putinin në Moskë

lufta në Ukrainë

### Çfarë moti do të mbretërojë në Kosovë në javën e dytë të shtatorit?

Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës

### Shkodër, arrestohet i dyshuari për disa raste të vjedhjeve

lende narkotike

**Rreth temës**

### Aktakuzë ndaj dy kirurgëve në Vushtrri për marrje ryshfeti

aktakuzë

### Qytetari në Vushtrri raporton se dikush ia vodhi dy pushkë gjuetie

Policia e Kosoves

### Dyshohet se kanosi punëtorët e KRU "Mitrovica" pas shkyçjes së ujit në pronën e tij, kërkohet paraburgim ndaj të dyshuarit

KRU Mitrovica



**6 të arrestuar për gjuajtje me armë në ahengje në 24 orët e fundit**

drenas

**Vrasja e djegia për së gjalli - çka thuhet në dosjen ndaj të akuzuarit për krime lufte në Reznik të Vushtrrisë?**

Aktakuza

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.